



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0637

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Kryetare, Batisha Ibrahim Anëtar dhe Vedat Poterqoi Anëtar duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “ANUAR” SH.P.K., kundër vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit si dhe OE “VIA EGNATIA” SH.P.K., kunder, vendimit për dhënie të një kontratë, të “Komuna e Prishtinës” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dimerore e rrugëve dhe trotuareve deblllokimi i kanalizimit atmosferik” me numër të prokurimit 616-23-13231-2-1-1, me 27/09/2024, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE “ANUAR” SH.P.K., Lot 8 me nr. 2024/0637, e datës 16/07/2024, kurse vendimi i AK “Komuna e Prishtinës” lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dimerore e rrugëve dhe trotuareve deblllokimi i kanalizimit atmosferik” me numër të prokurimit 616-23-13231-2-1-1 Lot 8 kthehet në **Rivlerësim**.

2. **Refuzohet**, si e pa bazuar ankesa e OE “VIA EGNATIA” SH.P.K., Lot: 1, 3, 9, dhe 11 me nr. 2024/0659, e datës 22/07/2024, kurse vendimi i AK “Komuna e Prishtinës” lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dimerore e rrugëve dhe trotuareve deblllokimi i kanalizimit atmosferik” me numër të prokurimit 616-23-13231-2-1-1 **mbetet ne fuqi**.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “ANUAR” SH.P.K., 5. Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

3.Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës “VIA EGNATIA” SH.P.K., në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me datë 27.11.2023 Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve debllokimi i kanalizimit atmosferik” me numër të prokurimit 616-23-13231-2-1-1. Autoriteti Kontraktues gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës për shërbim.

Me datë 03.07.2024, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 ku për lot 1, 3, 9 dhe 11 ka shpërblyer me kontratë disa operator të tjerë ekonomik ndërsa lotin 8 e ka anuluar në mungesë të ofertave të përgjegjshme.

Me datë 08.07.2024, OE ankues “VIA EGNATIA Sh.P.K.” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin B58, të cilën AK e ka refuzuar si të pabazuar me datë 11.07.2024. Me datë 22.07.2024 ankuesi “VIA EGNATIA Sh.P.K.” ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2024/0659.

Me datë 03.07.2024, GOE ankues “ANUAR Sh.P.K.” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin B58, të cilën AK e ka refuzuar si të pabazuar me datë 10.07.2024. Me datë 16.07.2024 GOE ankues “ANUAR Sh.P.K.” ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2024/0637.

- Mbi fazën e shqyrtimit paraprak -

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar ankesat sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “ANUAR Sh.P.K.” (2024/0637) janë se kundërshtohen arsyet për eliminimin e ankuesit nga ky aktivitet i prokurimit për shkak se (pretendimi nr. 1 – arsyeja e parë eliminuese) nuk i përmbush kërkesat e DT për makinerinë dhe (pretendimi nr. 2 – arsyeja e dytë eliminuese) nuk i përmbush kërkesat e DT për makinerinë.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “VIA EGNATIA Sh.P.K.” (2024/0659) janë si vijon:

Pretendimi nr. 1 – “AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së edhe kur e ka shpallur fitues GOE AVAG GROUP SH.P.K. ; EING COM SH,P,K.” në Lot-in 11 sepse i njëjti nuk posedon çmimin më të ulët, andaj me që ne jemi me çmim më të lirë në krahasim me këtë OE dhe jemi komplet të përgjegjshëm, AK është dashur të na shpallë neve si fitues. Mosveprimi i tillë konsiderohet shkelje e plotë të nenit 59 dhe 60 i LPP-së si dhe shkelje edhe e vendimit të OSHP-së. AK ka gjatë kthimit të përgjigjen në Kërkesën tonë për Rishqyrtim ka shkelur plotësisht nenin 108/A të LPP-së sepse përpos që nuk është përgjigjur realisht në pretendimet tona, ka munduar të manipuloj me të dhëna me të vetmin qëllim cilësimin e Kërkesës tonë për Rishqyrtim si kërkesë e palejuar. Kjo është absurde për deri sa në përgjigjen ndaj kërkesën tonë për rishqyrtim të datës 28.02.2024 i ka miratuar pjesërisht pretendimet tona dhe e ka anuluar vendimin për LOT 1 dhe Lot 9. Me që qëllimi i Kërkesës tonë është arritur duke e detyruar AK-në që të ndërroj vendimin në këto dy lot-e, ne nuk kemi pasur nevojë të vazhdojmë me ankesë në OSHP sepse qëllimi i pretendimeve tona është arritur. Për sa i përket asaj se gjoja OSHP paska konstatuar se ne LOT 3 dhe 11 ne jemi tenderues i papërgjegjshëm, kjo nuk i jep të drejtë AK-së që të na e cilësoj Kërkesën për Rishqyrtim si të pa lejuar. Po ashtu edhe ajo që thotë se gjoja Lot 1 dhe 9 nuk janë kthyer në rivlerësim me që OSHP ka konstatuar ashtu, është komplet absurde sepse neve AK i bie se na ka qitur në lajthitje kur ne vendim ka konstatuar se ndryshohet vendimi lidhur me nenin 1 dhe 9 që i bie se lënda rivlerësohet. Ne nuk kemi pasur nevojë të i drejtohem OSHP-së herën e parë të kontestimit të vendimit të AK-së me që pretendimet tona janë aprovuar pjesërisht të bazuara dhe vendimi i AK ka qenë që të ndryshohen vendimet për lot-et e cekura në vendim ku bënë pjesë edhe lot 1 dhe 9. Pra kërkesa për rishqyrtim nuk mundet të konsiderohet e palejuar në asnjë rast kur ndodh kjo që ka ndodhur tek AK. Kërkesa është aprovuar pjesërisht, AK ka vendos me ndryshua vendimin paraprak dhe ne s’kemi pasur nevojë të shkojmë fare në OSHP”.

Pretendimi nr. 2 – “AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së pasi që gjatë procesit të ri-vlerësimit të ofertave nuk i ka trajtuar të gjithë tenderuesit në mënyrë të barabartë. E themi këtë sepse edhe përkundër shumë mangësive të theksuara tek ofertat e disa nga OE/GOE që i ka shpallur fitues në lot 1, 3, 9 dhe 11, AK prapë ka vazhduar me shpërblimin e tyre me kontratë ndërsa nuk e ka marrë fare mundimin ta sqaroj një dokument të dërguar gabimisht nga ne, veprim i cili do të ja kursente së paku 20 % të buxhetit tek këto katër Lot-e. Vlen të theksohet se disa nga OE/GOE të shpallur fitues në lotët 1, 3, 9 dhe 11 nuk posedojnë dëshmi të rregullta lidhur me dëshmitë e ofruar sipas kërkesave të AK-së andaj me të drejtë është dashur të eliminohen nga konkurrenca. Dokumentet e tyre shihen qartë se janë jo të rregullta dhe janë dëshmi që nuk munden as të sqarohen prandaj trajtimi i tyre si të rregullta nga ana e AK-së konsiderohet favorizim i plotë ndaj tyre. Kjo nuk lejohet me asnjë nga dispozitat ligjore që flasin për vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit andaj shihet hapur se AK i ka favorizuar hapur tenderuesit e tillë. AK në të njëjtën kohë na ka diskriminuar neve si GOE tërësisht të përgjegjshëm dhe me çmime më të ulëta në këto Lot-e pasi që nuk ka kërkuar fare sqarime lidhur me marrëveshjen e anëtarit të grupit “OE Rahovica Commerce SH.P.K.” që e kishte me ATK-në.

Vërtetimi i ATK-së i dorëzuar nga ky OE bashkë me marrëveshjen e ATK-së shihet se ka datën më të hershme se marrëveshja dhe qartë e potencon se ky OE është në marrëveshje. Kjo hapur tregon se vërtetimi i tillë është lëshuar mbi bazën e një marrëveshjeje të mëhershme andaj AK është dashur ta kërkoj nga ne ose ta kërkoj drejtpërdrejt edhe nga vet ATK-ja. Elaborimin e ligjshmërisë së vendimit të AK-së në këtë pikë, të marrëveshjes me ATK-në si dhe detajet e mangësive në ofertat e OE dhe GOE që janë shpallur fitues në Lot-et 1,3,9 dhe 11, do të i shpalosim më detalisht në pretendimet tjera ku do ta argumentojmë gabimin dhe shkeljen e AK-së në trajtimin e tenderit tonë dhe të tenderëve të OE/GOE që i ka shpallur fitues në Lot-et e cekura më lartë”.

Pretendimi nr. 3 – *“Për sa i përket pretendimeve rreth çmimit jo-normalisht të ulët konsiderojmë se janë të pabazuara me që asnjëri nga kushtet e nenit 41 të RRPP-001/2022 nuk është plotësuar. Po ashtu edhe arsyetimi kinse në një pozicion na dallon çmimi krahasuar me një kontratë tjetër, kjo fillimisht nuk është e lejuar të krahasohet, ndërsa çmimi i tillë shihet se është çmim i tregut pasi që bëhet fjalë për shërbime që ofrohen në dimër që janë në sasi relativisht të vogla. Vlen të thuhet se edhe OE tjerë kanë çmime të njëjta por që nuk u janë kontestuar”.*

- Vlerësimi dhe administrimi i provave -

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 30.07.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2024/0637 të OE ankues “Anuar ShPK” ndërsa me datë 06.08.2024 është dorëzuar raporti i ekspertizës nga eksperti shqyrtues me rekomandimet si në vijim: *“Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim”*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 30.07.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2024/0659 të OE ankues “Via Egnatia ShPK” ndërsa me datë 09.08.2024 është dorëzuar raporti i ekspertizës nga eksperti shqyrtues me rekomandimet si në vijim: *“Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK”.*

Konstatimet e ekspertit shqyrtues lidhur me ankesën nr. 2024/0637 të OE “Anuar ShPK”

Lidhur me pretendimin nr. 1 – *“Gjatë vlerësimit të ofertës të OE-ANUAR sh.p.k, eksperti shqyrtues vlerëson se për kërkesën, lidhur për kontrata dhe referenca në vlerë prej 291.00.00 €, për LOT-8, operatori ekonomik i ka të dorëzuara dëshmitë të cilat janë lehtësisht të verifikueshme nga Autoriteti Kontraktues– Komuna e Prishtinës, andaj për të njëjtën kërkesë gjatë ri-vlerësimit të konstatohet saktë gjenja e dokumnetacionit gjatë ekzamimit, krahasimit dhe verifikimit të dëshmimeve (dokumenteve) të cilat janë dorëzuar si përgjigje nga OE, në kërkesat e parashtruara në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë nga AK*

Lidhur me pretendimin nr. 2 - “Gjatë vlerësimit të ofertës të OE-ANUAR sh.p.k, eksperti shqyrtues vlerëson se për kërkesën, lidhur me posedimin e pajisjeve Autortieti Kontraktues–Komuna e Prishtinës, në arsyen e eliminimit në sqarimet e dhëna, duke ditur se është një listë e gjatë e pajisjeve, të cilat duhet ti dëshmojë operatori ekonomik se i posedon. Po ashtu edhe në këtë arsye të eliminimit eksperti shqyrtues vlerëson se AK- Komuna e Prishtinës, nuk ka konstatuar gjendjen reale dhe faktike të dëshmive të ofruara nga OE-ankues “ ANUAR” sh.p.k, pasi që gjatë verifikimit të dëshmive për të njëjtën kërkesë në ofertën e OE-ankues ka dëshmi të cilat duhen të ri-analizohen dhe të ekzaminohen gjatë ri-vlerësimit”.

Konstatimet e ekspertit shqyrtues lidhur me ankesën nr. 2024/0659 të OE “Via Egnatia ShPK”

Lidhur me pretendimin nr. 1 – “Lidhur me pretendimin e OE-ankues për LOT-1 dhe Lot-9, eskeptri shqyrtues vlerëson se OE-ankues ka parashtruar ankesë si palë e cila nuk ka mundur të dëshmojë asnjë interes material nga cili do rezultat

Lidhur me pretendimin nr. 2 - “I njëjti pretendim është trajtuar nga OSHP-ja, dhe i njëjti pretendim ka pasur përgjigjen me rekomandim në vendimin e OSHP-së me numër 2024/0210, andaj pretendimi i njëjtë konsiderohet se është rast “ResJudicata”. Eksperti shqyrtues nuk mund të trajtoj edhe njëherë pretendimin e njëjtë për të cilin është marrë një Vendim parparak, dhe për të njëjtin nuk ka ndodhur ose krijuar ndonjë rrethanë e re e cila do të kishte ndikim në raport me Vendimin paraprak”.

Lidhur me pretendimin nr. 3 - “Lidhur me çmimet abnormalisht të ulëta është në përgjegjsi të Autoritetit Kontraktues të kërkojë sqarim nga OE - qoftë edhe për një pozicion për të cilin konsideron se vlerësohet si çmim abnormalisht i ultë. Pas dorëzimit të përgjigjes dhe arsyeve të OE, është në kompetencë të Autoritetit Kontraktues të konsideroj si çmim abnormalisht të ulët apo jo, duke u bazuar në arsyen e OE. Të gjithë këtë situatë rrethanë e parasheh edhe rregullorja me numër: 001-2022, Neni41 Tenderët Jo-normalisht të Ulët”.

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtruesit e palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës me nr. 2024/0659 të OE “Via Egnatia” sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues për këtë lëndë janë të sakta në tërësi dhe si të tilla mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit, ofertave të tenderuesve dhe dokumenteve të tjera që janë pjesë e këtij aktiviteti të prokurimit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotëkonstatimeve të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës me nr. 2024/0637 të OE “Anuar ShPK” sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues për këtë lëndë janë të qëndrueshme. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotëkonstatimeve të ekspertit shqyrtues.

Vlen të theksohet fakti se për Panelin Shqyrtues, konstatimet dhe rekomandimet e ekspertëve shqyrtues nuk janë të detyrueshme, por shërbejnë vetëm si një provë në mesin e të gjitha provave tjera që vlerëson në secilën lëndë veç e veç. Paneli Shqyrtues vendos në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdesin e duhur profesional duke mbrojtur gjithmonë interesin e publikut përmes LPP dhe legjislacionit sekondar në fuqi për prokurimin publik.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet tjera relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me ankesën me nr. 2024/0637 të OE “Anuar ShPK”:Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik ANUAR " SH.P.K. aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mirembajtja dimerore e rrugeve dhe trotuareve deblokimi i kanalizimit atmosferik” me nr. të prokurimit: "616-23-13231-2-1-1", të anulohet njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në rivlerësim sa i përket Lot-8. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si të bazuar, duke sugjeruar që aktiviteti i prokurimit në fjalë (Lot- 8) të rivlerësohet dhe gjatë rivlerësimit AK të veproj në zbatim me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sa i përket Lot-8 .

Lidhur me ankesën me nr. 2024/0659 të OE “Via Egnatia”:Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ka vepruar në përputhje me LPP në fuqi. Paneli Shqyrtues ka gjetur që konstatimi i ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimin e parë sipas të cilit parashtruesi nuk është palë e interesuar lidhur me këtë pretendim në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP, është konstatim i saktë. Ngjashëm edhe konstatimi i ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimin ankimor për vërtetimin e AK sipas të cilit ky pretendim është çështje e gjykuar “res iudicata”

pasi që tanimë është trajtuar përmes vendimin OSHP:2024/0210, është konstatim i saktë në tërësi. Tutje Paneli Shqyrtues ka gjetur se edhe konstatimi i ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimin për çmime jonormalisht të ulëta është pretendim i pabazuar pasi që autoriteti kontraktues ka vepruar në përputhje të plotë me nenin 41 të RRPP. Pra për të gjitha pretendimet e operatorit ankues, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë sqarimeve dhe konstatimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Mirëpo përtej këtyre fakteve, vlen të theksohet se autoriteti kontraktues e gëzon autonominë e plotë për të ekzaminuar, krahasuar edhe vlerësuar të gjitha ofertat e pranuar në një aktivitet të prokurimit. Duke qenë se në rastin konkret AK ka vlerësuar dokumentet në mënyrën e elaboruar si më sipër, nuk ekziston bazë e mjaftueshme për të kthyer në rivlerësim aktivitetin e prokurimit. Paneli Shqyrtues ka marrë parasysh edhe nenin 104 par. 4 të LPP ku përcaktohet se *“Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara OSHP duhet të veprojë në mënyrë proporcionale me shkëlqen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik”*. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues është nisur nga parimi themelor për mbrojtjen e interesit të publikut qoftë në aspektin e parandalimit të vonesave të paarsyeshme ashtu edhe në mbrojtjen e buxhetit publik të AK. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar ndërsa Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Komuna e Prishtinës i datës 03.07.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull *“Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve deblllokimi i kanalizimit atmosferik – Lot 1, 3, 9 dhe 11”* me numër të prokurimit 616-23-13231-2-1-1, duhet të mbetet në fuqi, pasi që nuk ekzistojnë argumente të mjaftueshme ligjore për të urdhëruar AK që të kthejë aktivitetin e prokurimit në rivlerësim, për arsye të elaboruara si më sipër në këtë vendim.

Paneli Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veprojë në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të iniciojë procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve të prokurimit.

Për pikën I, II, III dhe IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën V dhe VI të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - " ANUAR " SH.P.K., VIA EGNATIA SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: